



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 26 datë 18.04.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË BANIMI, SHËRBIMI DHE HOTELERIE 22 DHE 24 KATE, ME 5 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM SHYRI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektive zhvilluese shoqërive “Artech Group” sh.p.k. dhe “Edonil Konstruksion” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi, shërbimi dhe hotelerie 22 dhe 24 kate, me 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Shyri”, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Artech Group” sh.p.k. dhe “Edonil Konstruksion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 10/11/2025